



Biografi e shkurtër

Elona Sina është diplomuar në vitin 2004 në fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, dega “Financë”. Në vitin 2017 përfundon studimet pranë Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar (ACCA) në Mbretërinë e Bashkuar, “Diplomë e Avancuar në Kontabilitet dhe Biznes” e shoqëruar nga ACCA me shkresë ekuivalentimi si diplomë Bachelor UK. Në të njëjtin vit çertifikohet në Luksemburg “Programi i Pajtueshmërisë Normative” në fushën e instrumentave financiare (MIFID), mbrojtja e të dhënave personale, parandalimit të pastrimit të parave (AML/CDD), parandalimit të financimit të terrorizmit (CFT) dhe krimit financiar. Ka një përvojë pune prej më shumë se 14 vitesh në sektorin bankar. Filloi punë në vitin 2004 pranë Raiffeisen Bank Shqipëri SH.A në fushën e kredihënies dhe shërbimeve bankare për 2 vjet. Nga viti 2006 ka punuar pranë Veneto Banka SH.A në pozicione të ndryshme, ku në vitin 2008 emërohet si “Përgjegjëse e Parandalimit të Pastrimit të Parave” për një periudhë prej 8 vitesh dhe deri në Tetor 2018 si Drejtor i Departamentit të Pajtueshmërisë. Në tetor 2018 punoi në Intesa Sanpaolo Bank Albania pranë Departamentit të Pajtueshmërisë dhe nga janari 2019, iu bashkua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, me detyrën këshilltare ekonomike. Zotëron gjuhën angleze dhe atë italiane.